REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. 2819/1 prot. Tiranë, më 20.10.2026

REKOMANDIM

Nr.64, datë 20.10.2026

MBI ZBATIMIN E LIGJIT NR. 33/2022 "PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT TË SEKTORIT PUBLIK" NGA AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Në mbështetje të nenit 19 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik",

KONSTATOHET SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") është institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorim të dokumenteve të organeve të sektorit publik, referuar nenit 19, pika 1, të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" (në vijim "ligji nr. 33/2022").

Në zbatim të *"Planit të monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 33, datë 31.03.2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" nga organet e sektorit publik, për vitin 2026*", publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit, dhe Urdhrit nr. 53, datë 11.03.2026 "*Për miratimin e "Manualit të monitorimit online dhe metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike"*", u krye procesi i monitorimit, me objekt:

- *Monitorimi online i faqes zyrtare të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, në linkun https://geoportal.asig.gov.al/, lidhur me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e monitorimit *online* nga struktura përgjegjëse dhe provat e administruara gjatë këtij procesi monitorimi, vëren se:

- Ligji nr. 33/2022, në nenin 3 "Fusha e zbatimit", shkronja "a", përcakton se: *"Ky ligj zbatohet për ripërdorimin e: a) dokumenteve ekzistuese që mbahen nga organet e sektorit publik"*.

Në pikën 9 të nenit 6 të ligjit nr. 33/2022 përcaktohet se: *""Organet e sektorit publik" përfshin çdo organ të pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative; çdo organ të enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ të pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike".*

Për sa më sipër, në kuptim të ligjit nr. 33/2022, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor konsiderohet organ i sektorit publik dhe duhet të zbatojë detyrimet ligjore sipas dispozitave të mëposhtme të këtij ligji:

- Sipas nenit 6, pika 15: *""Të dhëna të hapura" është format i pavarur nga platforma, i vënë në dispozicion të publikut pa asnjë kufizim që pengon ripërdorimin e dokumenteve".*

- Sipas nenit 7, pika 3: *"Organi i sektorit publik përcakton listën e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, të cilën e bën publike".*

- Sipas nenit 9, pika 4: *"Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, për aq sa është e mundur teknikisht, i bëjnë të disponueshme të dhënat për ripërdorim menjëherë pas mbledhjes, përmes ndërfaqeve të përshtatshme API, në formë dinamike ose kur është e përshtatshme, si një shkarkim i vetëm voluminoz (bulk download)".*

- Sipas nenit 10, pikat 1, 2 dhe 5:

  "1. Ripërdorimi i dokumenteve, si rregull, ofrohet pa pagesë.

  2. Ripërdorimi i dokumenteve mund të bëhet kundrejt një tarife për të mbuluar kostot shtesë për arsye të riprodhimit, ofrimit e shpërndarjes së dokumenteve, për anonimizimin e të dhënave personale, si dhe për masat e marra për të mbrojtur informacionin sekret tregtar.

  5. Për çdo rast ku aplikohet tarifa, metodologjia, masa dhe përdorimi i tarifës duhet të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organi i sektorit publik që aplikon tarifa për të drejtën e ripërdorimit e bën atë publike në faqen e vet të internetit, si dhe në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura".

- Sipas nenit 11, pika 2: *"Ripërdorimi i dokumenteve është i hapur ose kundrejt aplikimit të licencës standarde. Në rastin e aplikimit të licencës standarde, licenca ofrohet në formatin elektronik sipas modelit të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*

- Sipas nenit 12, pika 1: *"Me qëllim lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura të ofruara nga organet e sektorit publik, krijohet/funksionon portali i të dhënave të hapura qeveritare. Ky portal krijohet dhe administrohet nga AKSHI".*

  Në interpretim të këtij neni, organet e sektorit publik duhet të mundësojnë ndërveprimin me portalin e të dhënave të hapura qeveritare, opendata.gov.al.

- Sipas nenit 16, pika 1: *"Në grupin e të dhënave me vlerë të madhe përfshihen të dhëna në fushat:*

  b) mjedisore dhe të vëzhgimit të tokës;
  ……."

- Sipas nenit 17, pikat 1 dhe 2:

  "1. Për çdo kategori të të dhënave me vlerë të madhe për ekonominë dhe shoqërinë nga organi/et publike përgjegjëse, në koordinim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përcaktohen grupet specifike të këtyre të dhënave.

  2. Grupet specifike të të dhënave me vlerë të madhe duhet të jenë:
  a) të disponueshme pa pagesë;
  b) të lexueshme nga kompjuteri;
  c) të ofruara përmes API-ve; dhe

  ç) kur është me rëndësi, të ofruara si një shkarkim i vetëm."

- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 2, datë 06.02.2025 "Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik", përcakton këto detyrime kryesore për organet e sektorit publik:

  - ✓ Sipas Kreut II, Fusha e zbatimit, shkronja "a": *"Ky udhëzim zbatohet nga organet e sektorit publik, për ripërdorimin e dokumenteve ekzistuese që mbahen prej tyre, në kuadër të detyrës publike."*
  - ✓ Sipas Kreut III, pika 2: *"Licenca do të jetë në format elektronik dhe do të shoqërojë informacionin që do të publikohet nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al."*
  - ✓ Sipas pikës 5: *"Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike do të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit lidhur me implementimin e licencave në formatin elektronik, për dokumentet në formatin e të dhënave të hapura, në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al, ripërdorimi i të cilave kërkon aplikimin e licencës standarde."*
  - ✓ Sipas Kreut V, pika 2: *"Ky udhëzim zbatohet nga organet e sektorit publik, sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit".*

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (në vijim "ASIG") është institucion publik qendror, krijuar me ligjin nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e

Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe, referuar këtij ligji e akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij, duhet të krijojë, mbledhë, përpunojë dhe publikojë të dhëna.

ASIG, referuar nenit 16 të ligjit nr. 33/2022, është institucioni përgjegjës për të dhënat me vlerë të madhe "gjeohapësinore".

Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga neni 17, pika 1 e ligjit nr. 33/2022, ASIG gjithashtu ka miratuar edhe Udhëzim nr. 560/3 prot., datë 28.05.2025 "Për përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore e vëzhgimit të tokës"".

Ky Udhëzim ka për qëllim përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore dhe vëzhgimit të tokës", lidhur me këto tema, për të cilat ASIG është autoriteti publik përgjegjës sipas Direktivës INSPIRE dhe ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe përcakton gjithashtu masat për publikimin dhe ripërdorimin e grupeve të të dhënave me vlerë të lartë, në veçanti kushtet e zbatueshme për ripërdorim dhe kërkesat minimale për shpërndarjen e të dhënave nëpërmjet ndërfaqeve të programimit të aplikacionit ("API").

Referuar sa më lart, ASIG ka detyrimin ligjor për publikimin e dokumenteve dhe të dhënave publike që mban dhe prodhon referuar akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi të sektorit publik, në format të hapur (*open data*), të lexueshëm nga kompjuteri, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, së bashku me *metadata*-n, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 33/2022.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve ligjore të mësipërme dhe detyrimeve të ligjit nr.33/2022, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin *online* të faqes zyrtare të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, konkretisht rubrikave dhe përmbajtjes së tyre, bazuar në dimensionet e vlerësimit të këtij procesi monitorimi, referuar "*Manualit të monitorimit online dhe metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike*".

Referuar ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për publikimin e të dhënave të mbledhura apo krijuara nga ASIG, është krijuar faqja zyrtare https://geoportal.asig.gov.al/, e cila administrohet nga ky Autoritet.

Nga monitorimi i kryer *online*, për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr.33/2022, rezulton se:

1. Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ka krijuar një *website* të dedikuar për publikimin e të dhënave të hapura https://geoportal.asig.gov.al/, ku gjenden të publikuara të dhënave që mban e prodhon ASIG, të cilat plotësojnë kriterin e listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, sikurse kërkohet nga neni 7, pika 3 e ligjit nr. 33/2022.

Pika 10 e nenit 3 të ligjit nr. 72/2012 përcakton se: *""Gjeoportal" është një sistem, i cili nëpërmjet internetit përdor një ndërfaqe grafike qendrore dhe unike, nëpërmjet së cilës përdoruesit mund të zbulojnë, të shikojnë dhe të përdorin informacionin gjeohapësinor dhe shërbimet e rrjetit që lidhen me këtë informacion, sipas përcaktimeve të këtij ligji".*

2. Nga verifikimi i përmbajtjes së rubrikave "Të dhënat" dhe "Shërbimet" në Gjeoportalin Kombëtar, konstatohet se ato përmbajnë të listuara temat dhe të dhënat që mbledh/përpunon/krijon/prodhon ASIG dhe autoritetet publike përgjegjëse, referuar detyrimeve ligjore sipas fushës së përgjegjësisë.

3. Për sa i përket formatit të të dhënave të publikuara, rezulton se jo gjithmonë ato janë në formate të hapura, të lexueshme nga kompjuteri dhe të ripërdorshme, referuar detyrimeve ligjore.

   Ligji nr. 72/2012, i ndryshuar, në nenin 12 përcakton se: *"1. Mbledhja, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave gjeohapësinore për secilën nga temat e përcaktuara nga neni 11 i këtij ligji, kryhen në përputhje me vendimet e ASIG-ut për secilën temë. 2. Në vendimin e ASIG-ut për secilën temë identifikohen autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore përkatëse, si dhe përcaktohen afatet për mbledhjen e të dhënave dhe depozitimin e tyre pranë këtij autoriteti. 3. Autoritetet publike, të identifikuara sipas pikës 2 të këtij neni, mbledhin, përpunojnë dhe përditësojnë të dhëna gjeohapësinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ASIG-ut, si dhe depozitojnë pranë këtij autoriteti të dhënat gjeohapësinore të mbledhura në afatin e përcaktuar prej tij".*

   Nga verifikimi i të dhënave të publikuara, rezulton se për të dhënat gjeohapësinore, për të cilat ASIG nuk është përgjegjës për krijimin e tyre, autoriteti publik përgjegjës jo gjithmonë i ka dorëzuar ato në format të hapur dhe, për pasojë, janë publikuar nga Autoriteti në këtë formë.

   Situata e evidentuar mbi cilësinë e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe (referuar Udhëzimit nr. 560/3 prot., datë 28.05.2025), të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar, paraqitet në Aneksin 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij Rekomandimi.

4. Në faqen e Gjeoportalit Kombëtar https://geoportal.asig.gov.al/, te rubrika "Kushtet e përdorimit" është publikuar logoja e licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC BY 4.0), që përcakton kushtet e ripërdorimit, referuar "Udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025 "Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik" dhe Udhëzimit nr. 560/3 prot., datë 28.05.2025 "Për përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore dhe vëzhgimit të tokës"".

5. Lidhur me aplikimin e tarifave për të drejtën e ripërdorimit të të dhënave të hapura, në këtë rast ndodhemi para dy situatave parashikuar në ligjin nr. 72/2012, si më poshtë.

Legjislacioni i posaçëm, konkretisht ligji nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se:

" Neni 26 "Ofrimi i të dhënave dhe shërbimeve":

1. Të dhënat gjeohapësinore, të vëna në dispozicion nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, sipas pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, që përfshihen në listën e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe, sipas legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, ofrohen pa pagesë nga ASIG;
2. Të dhënat dhe shërbimet e ASIG-ut, që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, mund të ofrohen kundrejt një tarife;
3. Lista e të dhënave dhe shërbimeve që do të tarifohen, si dhe masa e tarifës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, si dhe Udhëzimit nr. 560/3 prot., datë 28.05.2025 "Për përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore dhe Vëzhgimit të Tokës"", ASIG është përgjegjës për të dhënat gjeohapësinore dhe vëzhgimin e tokës, listuar në Aneksin 1 dhe 2 të këtij Udhëzimi. Në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 33/2022, dispozitës së sipërcituar dhe udhëzimit të mësipërm, "të dhënat gjeohapësinore dhe vëzhgimit të tokës" sipas Aneksit 1 dhe 2 të këtij Udhëzimi, ofrohen pa pagesë nga ASIG.

Referuar pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 72/2012, të dhënat dhe shërbimet e ASIG-ut, që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, mund të ofrohen kundrejt një tarife. Lidhur me këtë parashikim, ASIG ka miratuar VKM-në nr. 336, datë 19.06.2025 "Për miratimin e listës së të dhënave dhe shërbimeve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor që do të tarifohen, si dhe të masës së tarifës", i cili është publikuar në faqen zyrtare të ASIG-ut, në linkun https://asig.gov.al/wp-content/uploads/2025/06/vendim-2025-06-19-336.pdf.

6. Nga verifikimi në portalin opendata.gov.al, nuk gjenden të dhëna apo dokumente të publikuara nga ASIG lidhur me veprimtarinë e tij.

   Referuar këtij procesi monitorimi dhe vlerësimi, bazuar në dokumentin "*Metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike*", rezulton një nivel "përputhshmërie e mirë" e këtij organi të sektorit publik në zbatimin e ligjit nr. 33/2022.

   Ligji nr. 33/2022 përcakton se të dhënat e hapura nuk kanë vetëm funksion informues, por synojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ripërdorimin e informacionit të sektorit publik për qëllime ekonomike, sociale, kërkimore, inovative dhe zhvillimore.

   Në këtë kuptim, publikimi i të dhënave në formate të hapura dhe të lexueshme nga kompjuteri synon krijimin e mundësisë që këto të dhëna të analizohen, përpunohen, kombinohen dhe ripërdoren nga aktorë të ndryshëm publikë dhe jopublikë, në funksion të zhvillimit të politikave të bazuara në evidencë, rritjes së transparencës dhe nxitjes së inovacionit digjital.

Në mënyrë të veçantë, të dhënat gjeohapësinore dhe mjedisore e vëzhgimit të tokës përbëjnë kategori të të dhënave me vlerë të madhe (*high-value datasets*), sipas nenit 16 të ligjit nr. 33/2022 dhe standardeve të Direktivës (BE) 2019/1024, për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, kërkimin shkencor, monitorimin e ndotjes, menaxhimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin e shërbimeve digjitale me interes publik.

Për rrjedhojë, mospublikimi i tyre në formate të hapura, të strukturuara dhe të ripërdorshme, në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 33/2022, kufizon ndjeshëm mundësinë e përdorimit efektiv të informacionit publik nga qytetarët, komuniteti akademik, organizatat e shoqërisë civile, media dhe sektori privat.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 7, 9, 10, 11, 12, 17 dhe 19 të ligjit nr. 33/2022, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Organi i sektorit publik "Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor" të marrë masat që të dhënat e publikuara në Gjeoportalin Kombëtar, në rubrikën "Të dhënat/Shërbimet", të jenë në format të hapur/*open data*, të lexueshme nga kompjuteri, të aksesueshme dhe të ripërdorshme, së bashku me *metadata*-n (në zbatim të detyrimeve të nenit 9 të ligjit nr. 33/2022).

2. Të dhënat e publikuara, referuar Aneksit 1 dhe 2 bashkëlidhur, të jenë sipas kërkesave dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 560/3 prot., datë 28.05.2025 "Për përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore dhe vëzhgimit të tokës"", si dhe në zbatim të detyrimeve të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr. 33/2022.

3. Dokumentet/të dhënat të publikohen edhe në portalin opendata.gov.al, me *metadata* dhe përditësim periodik, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik".

4. Në zbatim të nenit 18 dhe pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", detyrimet e përcaktuara në këtë Rekomandim të plotësohen brenda 90 ditëve nga data e marrjes dijeni.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 20.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

ANEKSI 1
KATEGORIA "GJEOHAPËSINORE"

Situata e të dhënave të publikuara për kategorinë "Gjeohapësinore", referuar në: ***Temat e përcaktuara sipas ligjit nr. 72/2012, neni 11 (Aneksi I i Direktivës INSPIRE), të cilat duhet të jenë konform Udhëzimit nr. 560/3 prot., datë 28.05.2025***	
Kufijtë e njësive administrative (Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore - AMVV, Vendimi nr. 15, datë 07.11.2016)	*Kufijtë e Njësive Administrative të Republikës së Shqipërisë. Të dhënat janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 1078, datë 23.12.2015 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Kufijtë e njësive administrative".* ✓ *Rendi 1 (Kufiri Tokësor)* ✓ *Rendi 2 (Kufi Qarku)* ✓ *Rendi 3 (Kufi Bashki)* ✓ *Rendi 4 (Kufi njësie administrative)* ✓ *Rendi 5 (Qytete dhe Fshatra)* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/61d9ff32-c184-4546-b9a3-13a2c1e25456.*
Emërtimet Gjeografike (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG, Vendimi nr. 11, datë 07.11.2016)	*Emërtimet gjeografike përbëhen nga tre grupe të dhënash gjeohapësinore. Emërtimet gjeografike të relievit (toponimi), të hidrografisë dhe të fshatrave/qyteteve. Emërtimet gjeografike për relievin dhe hidrografinë janë përtuar nga digjitalizimi i hartave topografike të shkallës 1 : 25000. Emërtimet gjeografike të fshatrave dhe qyteteve janë marrë nga ndarjet administrativo-territoriale me ligjin nr. 115/ 2014 "Për ndarjen administravo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Të dhënat janë konform standardit me VKM-në nr. 142, datë 22.02.2017 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Emërtimet gjeografike".* ✓ *Emërtime Gjeografike 2018* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search;jsessionid=D8E87C8C4046ED3420298692DFCBA5A0?auto=true#/metadata/75882344-f460-4171-a457-2cd66b86359b.*
Sistemi i adresave (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile - DPGJC, Vendimi nr. 17 datë 07.11.2016)	*Sistemi i adresave për territorin e Republikës së Shqipërisë. Të dhënat janë marrë zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), me shkresën, nr. 7798/1 prot., datë 20.10.2014.* *Të dhënat nuk janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 859, datë 07.12.2016 "Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Sistemi i adresave".* ✓ *Ndërtesat (ADRESARI)* ✓ *Sistemi i Adresave, Numërtimi* ✓ *Sistemi i Adresave, Rrugë* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/26ba9998-10ae-4df2-b0e8-856e3a44bfb5.*
Ndërtesat (Agjencia Shtetërore e Kadastrës - ASHK, Vendimi nr. 18 datë 07.11.2016)	*Të dhënat nuk janë konform standardit me VKM-në nr. 321, datë 27.04.2016 "Për Miratimin e Dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Parcelat Kadastrale.* *Parcelat Kadastrale, Ndërtesat* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/feec42d6-feb6-4499-92a5-03ba9a8da82f.* *Ndërtesat Kadastrale (ALBSCAD)*

	https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/e5231c3d-2901-49f1-8269-c473305e121b.
Parcelat Kadastrale (Agjencia Shtetërore e Kadastrës - ASHK, Vendimi nr. 18, datë 07.11.2016)	*Të dhënat nuk janë konform standardit me VKM-në nr. 321, datë 27.04.2016 "Për Miratimin e Dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Parcelat Kadastrale".* *Parcelat Kadastrale, Parcelat.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/aad169e7-9f23-4ca2-be18-7a02118a9224.*
Parcela Bujqësore	*Të dhënat janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura. Miratuar me VKM-në nr. 390, datë 09.06.2022.* ✓ *Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/d4b8b897-c4d3-418f-b58a-3a222a7d8e57.*
Parcela Referente	*Parcelat Kadastrale, Parcelat - Të dhënat nuk janë konform standardit me VKM-në nr. 321, datë 27.04.2016 "Për Miratimin e Dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Parcelat Kadastrale".* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/aad169e7-9f23-4ca2-be18-7a02118a9224.* *Planet Kombëtare, Hartat tematike. Të dhënat nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri. Tema: Përdorimi i tokës. Miratuar me VKM- në nr. 811 datë 21.10.2020.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/1ef9418e-aa90-4ac4-ace3-bfe3cbd3830f* *Të dhënat e Corine 2018 janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Mbulesa e tokës". Miratuar me VKM- në nr. 809 datë 21.10.2020.* *Ndërsa të dhënat e Corine 2012 nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Mbulesa e tokës". Miratuar me VKM- në nr. 809 datë 21.10.2020.*

ANEKSI 2
KATEGORIA "MJEDISORE DHE VËZHGIMIT TË TOKËS", PËR TEMAT E DIREKTIVËS INSPIRE

Situata e të dhënave të publikuara për kategorinë "Mjedisore dhe vëzhgimit të tokës", referuar në temat e përcaktuara sipas ligjit nr. 72/2012, neni 11 (Aneksi I-III i Direktivës INSPIRE), të cilat duhet të jenë konform Udhëzimit nr. 560/3 prot., datë 28.05.2025	
Hidrografia (Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore - AMBU, Vendimi nr. 2, datë 12.06.2018)	*Hidrografia. - Të dhënat janë konform standardit me VKM- në nr. 829, datë 07.10.2015 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Hidrografia".* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search;jsessionid=690EEC5B4B7CA1F5B24C625F386CAC02?auto=true#/metadata/289c3b26-c047-41ca-a328-bd0ed897a357.* *Basenet - Të dhënat janë konform standardit me VKM-në nr. 829, datë 07.10.2015 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Hidrografia".* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search;jsessionid=C4EBF9B6E257A6D7C209BA2DE98E2304?auto=true#/metadata/1a773f26-3ab1-485f-be13-c8b3cd286dea.*
Zonat e Mbrojtura (Agjencia Kombëtare e Zonave te Mbrojtura - AKZM, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore - IKTK, Vendimi nr. 21, datë 07.11.2016)	*Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore* *Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore përfshijnë qendrat historike dhe zonat e tyre të mbrojtura, zonat arkeologjike të ndara sipas kategorive "A" dhe "B", duke u bazuar në intensitetin e pranisë së gjurmëve arkeologjike dhe zonat e mbrojtura të monumenteve të veçanta. Të dhënat janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Zonat e mbrojtura, të miratuar me VKM-në nr. 891, datë 18.11.2020.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/f83cbd24-a5ed-4d9b-9004-17e84d3a0e77.* *Monumente Natyre* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/e39dd8eb-046f-4912-bd14-b2e375099e63.* *Zonat e mbrojtura natyrore* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/1012ce38-f118-42c6-a610-9b9f468166ac.*
Modeli Digjital i Terrenit (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor -ASIG, Vendimi nr. 13, datë 07.11.2016)	*Të dhënat janë konform standardit me VKM-në nr. 398, datë 19.06.2019 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Modeli digjital i terrenit".* ✓ *Hillshade i Modelit Digjital të Terrenit* ✓ *Modeli Digjital i Sipërfaqes (DSM 2015- 2017) 3D* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/f24fbacb-dd44-4655-bfdc-82b470239526.*
Gjeologjia (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - SHGJSH, Vendimi nr. 20, datë 07.11.2016)	*Gjeologjia, Hartat tematike - Hartat tematike për 12 qarqet në Republikën e Shqipërisë të ndërtuara sipas hartave gjeologjike. Të dhënat nuk janë konform standardit me VKM-në nr. 134, datë 20.03.2019 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Gjeologjia".* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/e21786db-2d97-4b36-85ae-67693fc3f9a4.*
Mbulesa e Tokës (Agjencia Kombëtare e Mjedisit - AKM, Vendimi nr. 22, datë 08.11.2016)	*Të dhënat e Corine 2018 janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri. Tema: Mbulesa e tokës- Miratuar me VKM-në nr. 809, datë 21.10.2020.*

	Ndërsa të dhënat e Corine 2012 nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri. Tema: Mbulesa e tokës - Miratuar me VKM-në nr. 809, datë 21.102020. *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/9517e163-940f-408f-b2f2-948eeb8e65cd.* *ALFIS, Nënparcela pyjore* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/3ec2424b-81e0-40c5-983c-df1bef4d7a86.* *ALFIS, Kufiri i ekonomisë pyjore* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/6e15d786-1632-44a3-bbd2-5bb8f174369e.* *Harta e lartësive të mbulesës pyjore* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/bee15456-e49a-4fad-8d9a-1831b546cdaf.* *Të dhënat janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor - Tema: Mbulesa e tokës*
Ortoimazheria (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor -ASIG, Vendimi nr. 14, datë 07.11.2016)	*Mbulesa Ortoimazherike 1957 - Të dhënat janë konform standardit me VKM-në nr. 397, datë 19.06.2019 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Ortoimazheria". Miratuar me VKM-në nr. 397, datë 19.06.2019.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/08f4e2e8-15eb-4ad9-bc72-ea198f36dcbb.* *Ortofoto Satelitore CIR 2023* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/18e80aa5-a6bb-4c0e-b229-9a464121af90.* *Ortoimazheria* *Të dhënat e ortofotove 2019 (UAV), ortofoto 2018 (8 cm), ortofoto 2015 (8 cm), ortofoto CIR 2015 (8cm), ortofoto 2015 (20 cm), ortofoto CIR 2015 (20 cm), ortofoto 2001, ortofoto 1999, ortofoto 1994, ortofoto 1976-1986 dhe Ortofoto 1976-1986 (1:25 000) janë konform standardit me VKM-në nr. 397, datë 19.06.2019 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Ortoimazheria".* *Të dhënat e ortofoto 2007 nuk janë konform standardit me VKM-në nr. 397, datë 19.06.2019 - Tema: Ortoimazheria".* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/4aa2f756-0bec-4a25-a1a8-662bda31ff4f.* *Ortofoto Satelitore 2026* *Ortofoto Satelitore 2026 mbulon 60.5% të territorit të Republikës së Shqipërisë me imazhe satelitore të mbledhura gjatë periudhës 9 maj 2026 deri në 21 korrik 2026. U përftua përmes projektit "Shërbimi Satelitor" financuar nga Qeveria Shqiptare dhe ka si qëllim monitorimin e territorit Shqiptar me teknologji të avancuar. ASIG prodhoi Ortofoton Satelitore 2026, bazuar në VKM-në nr. 863, datë 27.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime" në VKM-në nr. 147, datë 20.02.2013 "Për Miratimin e Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor""* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/88e20038-8763-4bb1-9118-afa411fbdeb2.*
Zonat me përdorim të kufizuar (Agjencia e Zhvillimit të Territorit - AZHT Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore –	*Nuk ka të dhëna të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.*

AKBN, Vendimi nr.14, datë 05.04.2017)	
Zonat Ekologjike (Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura - AKZM, Vendimi nr.12, datë 05.04.2017	*Të dhënat nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Zonat Ekologjike. Miratuar me VKM-në nr. 571, datë 11.10.2023.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search;jsessionid=DED2E7749912454429E4186AA4F75CCB?auto=true#/metadata/d5fb3afe-0e18-4be2-86a0-1ecd55ed3ff6.*
Burimet Energjetike (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - AKBN, Vendimi nr. 18, datë 09.07.2017)	*Monitorimi i HEC-eve - Të dhënat janë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Burimet energjetike. Miratuar me VKM-në nr. 950, datë 02.12.2020.* ✓ *Monitorimi i HEC- eve, Lidhje e Nënveprave* ✓ *Monitorimi i HEC- eve, Nënvepër Hidrocentali* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/c6af973a-7f6a-4584-aeed-bd54ff16fa51.*
Infrastruktura për monitorimin e mjedisit (Agjencia Kombëtare e Mjedisit- AKM. Vendimi nr. 09 datë 5.04.2017)	*Të dhënat janë konform standardit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Infrastruktura për monitorimin e mjedisit". Miratuar me VKM-në nr. 210, datë 13.04.2023.* ✓ *Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ujërave të lagunave.* ✓ *Rrjeti i monitorimit të zhurmave urbane* ✓ *Vlerësimi i përmbajtjes së metaleve të rënda në ujërat sipërfaqësorë: lumenj, liqene dhe laguna në Territorin e Republikës së Shqipërisë.* ✓ *Rrjeti i monitorimit të tregueseve fiziko-kimike të ujërave të shkarkimeve urbane.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/5372f361-7c85-430e-99b9-93a8dcd20405.*
Habitatet (Agjencia Kombëtare e Zonave te Mbrojtura - AKZM, Vendimi nr. 12, datë 05.04.2017)	*Nuk ka të dhëna të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.*
Përdorimi i Tokës (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit - AKPT Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB, Fushë-Krujë, Vendimi nr. 5, datë 05.04.2017)	*Planet Kombëtare, Hartat tematike. Të dhënat nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Përdorimi i tokës. Miratuar me VKM-në nr. 811, datë 21.10.2020.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/1ef9418e-aa90-4ac4-ace3-bfe3cbd3830f.*
Burimet minerare (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - AKBN; Shërbimi Gjeologjik Shqiptar – SHGJSH, Vendimi nr. 2, datë 05.04.2017)	*Burimet Minerare - Harta e Pasurive minerare në shkallë 1:200.000 paraqet vendburimet e mineraleve kryesore të Shqipërisë. Harta ka për qëllim të informojë grupet e interesuar lidhur me pasuritë minerale të Shqipërisë. Vetëm të dhënat për Burimet Minerare, Lejet Minerare të Shfrytëzimit janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Burimet minerare. Miratuar me VKM-në nr.997, datë 09.12.2020.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search?auto=true#/metadata/c08b6e27-ab7b-4b24-b720-d83f151f15ec.*
Zonat me rreziqe natyrore	*Harta e Rrezikut nga përmbytjet - Të dhënat janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 810, datë 21.10.2020. Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri*

(Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile - AKMC Vendimi nr. 6, datë 05.04.2017)	*- Tema: "Zonat me Rreziqe Natyrore". Miratuar me VKM-në nr. 810, datë 21.10.2020.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/06cb00a9-7396-4cad-a1f4-d36d53de5e74.*
Infrastruktura Industriale (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Vendim nr. 16, datë 05.04.2017)	*Nuk ka të dhëna të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.*
Detet (Shërbimi Hidrografik Shqiptar -SHHSH, Komanda e Forcës Detare, Vendimi nr. 8, datë 05.04.2017)	*Nuk ka të dhëna të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.*
Pedologjia (Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB, Fushë-Krujë. Vendimi nr. 17, datë 14.06.2017)	*Pedologjia - Meqenëse baza e të dhënave gjeohapësinore për Pedologjinë është krijuar sipas studimit të realizuar në vitin 2001 këto të dhëna nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Pedologjia. Miratuar me VKM-në nr. 951, datë 02.12.2020.* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/1c214753-f246-4bd8-b331-28a85a906c9c*
Shpërndarja e specieve (Agjencia Kombëtare e Mjedisit -AKM; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura – AKZM, Vendim nr. 11, datë 05.04.2017)	*Shpërndarja e Specieve - Të dhënat nuk janë konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Shpërndarja e Specieve. Miratuar me VKM-në nr. 572, datë 11.10.2023.* ✓ *Shpërndarja e Specieve Fauna* ✓ *Shpërndarja e Specieve Flora* *https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search#/metadata/635841d7-59a0-4669-8f59-90d7e07d3b89.*